



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 204/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.04.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr. Ref-44396-02-06-2018, me objekt: “*Sherbim me roje private*”, me fond limit 5.831.482 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 19.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Lushnje. Gjithashtu ngrihen pretendime për ofertues të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Force Security 2004” sh.p.k,

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Polsaiz” sh.p.k.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k. Gjithashtu ngrihen pretendime për ofertues të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Myrto Security” sh.p.k. Gjithashtu ngrihen pretendime për ofertues të tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Ankimues:

“Eurogjici Security” sh.p.k
Rr. “Adem Jashari”, L.8, H.10, Ap.3,
Tiranë

“Force Security 2004” sh.p.k
L. “Kastriot”, godina e Albtelecom, Kati 3,
Fier

“Polsaiz” sh.p.k
L. “15 Tetori”, Rr. “Kastriot”,
Fier

“Nazeri 2000” sh.p.k
Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kati II,
Tiranë

“Myrto Security” sh.p.k
L. “Kastriot”, Rr. “Brigada 11 Sulmuese”, Godina e Albtelecom,
Fier

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Spitalit Lushnje,
Lagja “Xhevdet Nepravishta”,
Lushnje

Public Health Sector

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë

ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 07.02.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Marrëveshje kuadër” me Nr. Ref-44396-02-06-2018, me objekt: “Sherbim me roje private”, me fond limit 5.831.482 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 19.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Lushnje.

II.2. Në datën 23.02.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar, si vijon:

1. “Polsaiz” sh.p.k	5600803,00 lekë, skualifikuar
2. “Force Security 2004” sh.p.k	5602180,00 lekë, skualifikuar
3. “Eurogjici Security” sh.p.k	5823910,00 lekë, skualifikuar
4. “Nazeri 2000” sh.p.k	5829575,00 lekë, skualifikuar
5. “Elezaj” sh.p.k	5830115,00 lekë, skualifikuar
6. “Myrto Security” sh.p.k	5830662,00 lekë, skualifikuar
7. “Goga” sh.p.k	5831459,00 lekë, skualifikuar
8. “Buzi 2010” sh.p.k	5831482,00 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k është njoftuar elektronikisht lidhur me skualifikimin e tij pasi:

“Analiza e kostos nuk eshte bere e saktë.”

II.3.1. Në datën 24.02.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k, pasi, sipas tij, është paraqitur preventivi dhe analiza e detajuar e kostos, duke përfshirë dhe duke respektuar të gjitha zërat e kërkuar të ofertës sipas parashikimeve ligjore në fuqi [...]. Gjithashtu ankimuesi

kërkon të mbeten të skualifikuar operatorët ekonomikë “Polsaiz” sh.p.k dhe “Force Security” sh.p.k për arsye se ofertat e tyre janë nën minimumin e lejuar ligjor [...]”

II.3.2. Nëpërmjet shkresës nr. 333/2 prot., datën 02.03.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

II.3.3. Në datën 06.03.2018 operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.3.4. Në datën 15.03.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 425/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.400/1 prot., datë 13.03.2018 me objekt: “*Dërgim informacioni*”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.4. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik “Force Security 2004” sh.p.k është njoftuar elektronikisht lidhur me skualifikimin e tij pasi:

“Nuk ka kontrata te ngjashme me vlere 40 % e vleres se fondit limit...”

II.4.1. Në datën 26.02.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar se arsyeja e skualifikimit: “analiza e koston nuk është e saktë” është e gabuar pasi [...] oferta e paraqitur është sipas kërkesave ligjore dhe ato të specifikuara në dokumentat e tenderit. Sipas ankimuesit, sic rezulton nga analiza e cmimit të ofertës së paraqitur prej tij në këtë procedurë prokurimi, janë përlogaritur të gjitha shpenzimet sipas formularit të preventivit të DT-ve.

II.4.2. Nëpërmjet shkresës nr. 351/2 prot., datën 02.03.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar pretendimin e ngritur nga ky i fundit lidhur me analizën e koston.

II.4.3. Në datën 12.03.2018 operatori ekonomik “Force Security 2004” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.5. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik “Polsaiz” sh.p.k është njoftuar elektronikisht lidhur me skualifikimin e tij pasi:

“Analiza e koston nuk eshte bere e saktë.”

II.5.1. Në datën 01.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka nisur, nëpërmjet shërbimit postar, ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit. Sipas gjurmimit të bërë në faqen on-line të Postës Shqiptare sh.a, si dhe referuar dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi, kjo ankesë nuk ka mbërritur në adresën e autoritetit kontraktor.

II.5.2. Në datën 12.03.2018 operatori ekonomik “Polsaiz” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k është njoftuar elektronikisht lidhur me skualifikimin e tij pasi:

“Analiza e kostos nuk eshte bere e saktë.”

II.6.1. Në datën 28.02.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së shoqërisë “Nazeri 2000” sh.p.k, pasi, sipas tij, është paraqitur analiza e kostos, sipas kërkesave të dhëna në dokumentat e tenderit[...]. Gjithashtu ankimuesi ngre pretendime për operatorët ekonomikë “Polsaiz” sh.p.k dhe “Force Security” sh.p.k dhe “Eurogjici Security” sh.p.k.

II.6.2. Nëpërmjet shkresës nr. 346/2 prot., datën 02.03.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën. Përgjigja e autoritetit kontraktor ka mbërritur në adresën e ankimuesit në datën 05.03.2018.

II.6.3. Në datën 12.03.2018 operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6.4. Në datën 12.03.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 425/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.400/1 prot., datë 13.03.2018 me objekt: *“Dërgim informacioni”*, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.7. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik “Myrto Security” sh.p.k është njoftuar elektronikisht lidhur me skualifikimin e tij pasi:

“Analiza e kostos nuk eshte bere e saktë.”

II.7.1. Në datën 02.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së shoqërisë “Myrto Security” sh.p.k, pasi, sipas tij, janë respektuar të gjitha kërkesat ligjore e nënligjore në llogaritjen e cmimit të ofertës [...]. Gjithashtu ankimuesi ngre pretendime për operatorët ekonomikë “Polsaiz” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k dhe “Nazeri 2000” sh.p.k.

II.7.2. Nëpërmjet shkresës nr. 366/2 prot., datën 05.03.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën.

II.7.3. Në datën 13.03.2018 operatori ekonomik “Myrto Security” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.7.4. Në datën 15.03.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 425/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr.400/1 prot., datë 13.03.2018 me objekt: “Dërgim informacioni”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të secilit prej operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” sh.p.k, “Nazri 2000” sh.p.k dhe “Myrto Security” sh.p.k se: “Analiza e koston nuk është bere e saktë”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas

shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.1.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.1.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomik – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përlogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.1.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përlogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta. Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimes duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.1.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t'i kërkojë të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, në Shtojcën 1 “Formulari i ofertës”, në pjesën “Sqarim”, autoriteti kontraktor ndër te tjera ka përcaktuar:

Sqarime:

1. *Ne cmim te jene te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.*
2. *Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertes te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.*

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /dite	Vlera (Lek) 1 vëndroje me tre turne /dite
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh per 1 roje ne dite		
	Vlera totale me tvsh per 1 roje ne dite		

- *Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".*
- *Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vëndroje me tre turne të llogaritet **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).*
- *Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore,), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.*
- *Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit.*

III.1.9. Ndërkohë në shtojcën 7, "Kriteret e veçanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 6 e dokumentave të tenderit, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

"Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur. (Shih Shtojca 1 - Sqarime)

III.1.10. Në shtojcën 8 "Specifikimet teknike" të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

"Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Sherbimi do të jetë i organizuar me dy Vëndroje me tre turne me shërbim 24 ore çdo ditë, nga të cilat:

-Shërbimi në një vëndroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)

-Shërbim në një vëndroje në ambiente të tjera të spitalit (specifikohet në momentin e nënshkrimit të kontratës) me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)."

III.1.11. Ndërsa në shtojcën 10 "Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit" të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shërbimi që kërkohet: Objekti: "Ruajtja e godinës dhe e ambienteve rrethuese të godinës së institucionit me roje private" – Marrveshje Kuader - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar)

Vëndndodhja e shërbimit: Territori i Spitalit Lushnje

<i>Numri i Vëndrojeve</i>	<i>Numri i turneve</i>	<i>Numri i rojeve të nevojshme</i>	<i>Afati i levrimit</i>
2	3	9.96	12 muaj <i>Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedurë prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat përfundimtar 12 muaj.</i>

III.1.12. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ju ka kërkuar të gjithë ofertuesve që të paraqesin ofertën e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore, si dhe gjatë këtyre përlllogaritjeve të merren parasysh të gjitha parashikimet ligjore në lidhje

me pagën bazë minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë; si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën.

Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Komisioni vëren se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë paraqitur ofertat e tyre ekonomike bazuar në analizën e kostos ditore të kryerjes së shërbimit, përkatësisht për 1 roje/ditë, për 1 vëndroje me tre turne/ditë- në përputhje me dokumentat e tenderit; ndërkohë që vlerësimi dhe renditja e ofertave të operatorëve ekonomikë nga KVO është kryer mbi bazën cmimit total të kryerjes së shërbimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur nga ankimuesit, dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi i ofertave të paraqitura të operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” sh.p.k, “Nazeri 2000” e “Myrto Security” sh.p.k dhe konkretisht elementëve bazë të analizës së kostos (pagë bazë, shtesa mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%) – elementë këta të cilat janë përcaktuar shprehimisht dhe në DST, gjykon se operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k e “Nazeri 2000” sh.p.k nuk kanë respektuar dispozitat ligjore për pagën bazë minimale si dhe detyrimet ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë periudhën e kryerjes së shërbimit, ndërsa operatori ekonomik “Myrto Security” sh.p.k, ka respektuar dispozitat ligjore për pagën bazë minimale, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe detyrimet ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë periudhën e kryerjes së shërbimit.

Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga AK me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, operatorët ekonomikë “Eurogjici Security” sh.p.k, e “Nazeri 2000” sh.p.k nuk kanë përmbushur detyrimet bazë për një ofertë të sukseshme, siç janë llogaritja saktë e pagës bazë dhe të kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, në masën dhe vlerat e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k nuk qëndron.

Pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k nuk qëndron.

Pretendimi i operatorit ekonomik “Myrto Security” sh.p.k qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k për sa u përket shoqërive “Polsaiz” sh.p.k dhe “Force Security 2004” sh.p.k, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik ankimues “Eurogjici Security” sh.p.k. pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, ky i fundit nuk gëzon më interes të ligjshëm në përputhje me pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi pozitat e këtij të fundit në këtë procedurë prokurimi nuk do të ndryshonin.

III.2.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është

dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k përsa u përket shoqërive “Polsaiz” sh.p.k dhe “Force Security” sh.p.k dhe “Eurogjici Security” sh.p.k, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k. pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, ky i fundit nuk gëzon më interes të ligjshëm në përputhje me pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi pozitën e këtij të fundit në këtë procedurë prokurimi nuk do të ndryshonin.

III.3.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.3.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Force Security 2004” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik “Force Security 2004” sh.p.k është njoftuar elektronikisht lidhur me skualifikimin e tij pasi:

“Nuk ka kontrata te ngjashme me vlere 40 % e vleres se fondit limit..”

III.4.2. Në datën 26.02.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar se arsyeja e skualifikimit: *“analiza e kostos nuk është e saktë”* është e gabuar pasi [...] oferta e paraqitur është sipas kërkesave ligjore dhe ato të specifikuara në dokumentat e tenderit. Sipas ankimuesit, sic rezulton nga analiza e cmimit të ofertës së paraqitur prej tij në këtë procedurë prokurimi, janë përlogaritur të gjitha shpenzimet sipas formularit të preventivit të DT-ve.

III.4.3. Nëpërmjet shkresës nr. 351/2 prot., datën 02.03.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar pretendimin e ngritur nga ky i fundit lidhur me analizën e kostos.

III.4.4. Në datën 12.03.2018 operatori ekonomik “Force Security 2004” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

III.4.5. Në ankesën e paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e shoqërisë “Force Security 2004” sh.p.k konstatohet se ankimuesi nuk ka kundërshtuar arsyen e skualifikimit të tij nga KVO-ja *“Nuk ka kontrata te ngjashme me vlere 40 % e vleres se fondit limit”*, për të cilën është vënë në dijeni nëpërmjet SPE-së. Lidhur me pretendimin e tij të parashtruar në autoritetin kontraktor dhe KPP nga kjo shoqëri se: *arsyeja e skualifikimit: “analiza e kostos nuk është e saktë” është e gabuar [...]*, nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se nuk përbën arsye skualifikimi.

III.4.6. Duke mbajtur në konsideratë faktin që sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve dhe shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, arsyeja e skualifikimit nuk është ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në KPP. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* *“Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”* *“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”*. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: *“Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton*

ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Force Security 2014” sh.p.k, nuk janë ndjekur shkallët e ankimimit lidhur me arsyen e skualifikimit: *“Nuk ka kontrata te ngjashme me vlere 40 % e vleres se fondit limit”*.

Në këto kushte, duke qënë se aktualisht kanë përfunduar afatet e ankimimit në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, rrjedhimisht arsyja e skualifikimit e cila nuk është ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në KPP, nuk mund të merren në shqyrtim nga ky komision e për rrjedhim ai rezulton të ngelet i skualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Edhe në hipotezën se pretendimet e tjera të paraqitura pranë autoritetit kontraktor e më pas në KPP do të qëndronin, operatori ekonomik ankimues nuk do të ndryshonte gjendjen e tij faktike e juridike, por do të mbetej sërish i skualifikuar nga procedura në fjalë, për shkakun e skualifikimit të bërë me dije në datën 23.02.2018, e cila nuk është ankimuar pranë autoritetit kontraktor e më pas në KPP, në respekt të shkallëve të ankimimit.

Përsa më sipër, ankesa e operatorit ekonomik “Force Security 2004” sh.p.k, përsa i përket skualifikimit të tij, nuk do të merret në shqyrtim.

III.5. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Polsaiz” sh.p.k, vlerëson të ndalet në arsyetimin, përsa i përket respektimit të kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Vlen të sqarohet se nisur nga faktet dhe dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi në depozitimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit vendosi pezullimin e procedurës së prokurimit, me qëllim marrjen e informacionit dhe dokumentacionit të duhur nga ana e autoritetit kontraktor, për verifikimin e fakteve dhe rrethanave përkatëse, të vlefshme për të vlerësuar në lidhje me respektimin e kushteve formale nga ana e operatorit ekonomik ankimues, pa i hyrë në thelb shqyrtimit të pretendimeve të tij, për faktin se respektimi i kushteve formale, dhe konkretisht në lidhje me afatet e ankimimit, nga ana e operatorit ekonomik ankimues, nuk ishin shumë të qarta vetëm nga dokumentacioni i paraqitur prej tij në depozitimin e ankesës.

Në lidhje me këto afate, pas shqyrtimit, verifikimit e ballafaqimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, me atë të paraqitur nga autoriteti kontraktor, rezulton si më poshtë:

III.5.1. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik “Polsaiz” sh.p.k është njoftuar elektronikisht lidhur me skualifikimin e tij pasi: *“Analiza e kostos nuk eshte bere e saktë.”*

III.5.2. Në datën 01.03.2018 operatori ekonomik ankimues ka nisur, nëpërmjet shërbimit postar, ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar arsyen e skualifikimit. Sipas gjurmimit të bërë në faqen on-line të Postës Shqiptare sh.a, si dhe referuar dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi dhe autoriteti kontraktor, kjo ankesë nuk ka mbërritur në adresën e autoritetit kontraktor.

III.5.3. Në datën 12.03.2018 operatori ekonomik “Polsaiz” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

III.5.4. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar:

“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

III.5.5. Në rastin konkret, nga verifikimet e kryera, rezulton se ankesa e operatorit ekonomik nuk është depozituar në autoritetin kontraktor, megjithëse është nisur me postë në datën 01.03.2018. Operatori ekonomik ka dorëzuar ankesë pranë K.P.P. më datë 12.03.2018, pra pa respektuar afatet e ankimit, parashikuar nga neni 63, pika 6 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ç’ka rrjedhimisht sjell si pasojë që ankimuesi të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit në K.P.P, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 23, pikës 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit.

III.5.6. Në nenin 17 “Forma dhe përmbajtja e ankesës” të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

1. Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës.

2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

a) Të dhënat identifikuese të ankimuesit;

b) Dokumentet e tenderit;

c) Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi;

ç) Bazën ligjore;

d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;

dh) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka;

e) Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën;

ë) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar.

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

a) provat dokumentare, të cilat ankimesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;

b) kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;

c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

Ndërsa në nenin 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

1. Komisioni zhvillon mbledhjen e tij të parë brenda 3 ditëve nga regjistrimi i ankesës me qëllim shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, në të cilën verifikon:

a) juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;

b) legjitimitetin e ankuesit;

c) respektimin e afateve ligjore për ankimin;

d) elementet e domosdoshme të ankesës të parashikuara në nenin 17 pika 2 të kësaj rregulloreje.

2. Relatori verifikon paraprakisht kushtet formale të ankesës dhe nëse autoriteti kontraktor e ka pezulluar procedurën e prokurimit. Ai i relaton Komisionit rezultatet e verifikimit.

3. Komisioni voton sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 10 të kësaj rregulloreje dhe vendos:

a) Mospranimin e ankesës për shkak të mungesës së kushteve formale të saj, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Në këtë rast, Komisioni ia njofton vendimin ankimesit brenda 3 ditëve, duke i treguar edhe të drejtën për t’u ankuar në gjykatë, si dhe autoritetit kontraktues me qëllim që ky i fundit të marrë masat për vazhdimin e procedurës së prokurimit publik nëse e ka pezulluar atë;

b) Kalimin e ankesës për shqyrtim, duke marrë një prej vendimeve të parashikuara në nenin 25 të kësaj rregulloreje. Në këtë rast, me kërkesë të relatorit të bazuar në aktet e bashkëlidhura ankesës, Komisioni vendos edhe nëse duhet marrë mendimi i specialistëve/ekspertëve të pavarur, si dhe njofton ankuesin për afatin e parapagimit të ekspertëve. Njoftimi përmban edhe paralajmërimin se në rast të mosparapagimit të ekspertizës në afatin e caktuar, Komisioni nuk thërret dhe nuk merr si provë ekspertizën e kërkuar.

III.5.7. Në nenin 82 “Barra e provës”, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se: “1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj [...]”.

Theksojmë faktin se, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiteti, juridiksioni, kompetenca, elementët e domosdoshëm të ankesës etj dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimes pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimesit, ankimimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për

prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk ka plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 23, pika 3, shkronja “a”, të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mungesës së kushteve formale të saj.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Myrto Security” sh.p.k përsa u përket ofertuesve të tjerë “Polsaiz” sh.p.k, “Eurogjici Security” sh.p.k dhe “Nazeri 2000” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merret në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorëve ekonomikë në fjalë do të mbetet e skualifikuar, nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesat e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merret në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k në procedurën e prokurimit “*Marrëveshje kuadër*” me Nr. Ref-44396-02-06-2018, me objekt: “*Sherbim me roje private*”, me fond limit 5.831.482 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 19.02.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Lushnje.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Force Security 2004” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Polsaiz” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
4. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
5. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk për procedurën e prokurimit të lartpërmendur.
6. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Myrto Security” sh.p.k, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si mësipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.
7. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

8. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Myrto Security” sh.p.k.
9. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 425 Protokolli; Datë 06.03.2018

Nr. 457 Protokolli; Datë 12.03.2018

Nr. 469 Protokolli; Datë 12.03.2018

Nr. 473 Protokolli; Datë 12.03.2018

Nr. 484 Protokolli Datë 13.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

